



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV), ishte nënvlerësuar për 995,305€, ndërsa e pasurive jo kapitale për 41,497€, si rezultat i mos regjistrimit dhe mos shpalosjes së pasurive;
- B2 Gjatë vitit 2023 MKRS kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 135,322€ në kategori ekonomike jo adekuate;
- C1 Në PFV, pasqyra e pranimeve dhe pagesave ishte nënvlerësuar për vlerën 36,167€, si rezultat i mos prezantimit të kthimit të donacioneve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Në 19 raste në vlerë prej 2,585,765€ nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohet me marrëveshje;
- A1 Në dy (2) raste të testuara në vlerë 849,699€, kishte dobësi në procedura të prokurimit;
- A2 Në nëntë (9) kontrata të nënshkruara për përfituesit e subvencioneve në vlerë totale 326,082€ u identifikuan dobësi rreth procesit të nënshkrimit të kontratave;
- C2 Në tre (3) raste të testuara në vlerë 163,481€, MKRS kishte lidhur kontrata duke mos i respektuar afatet e përcaktuara;
- C3 Në katër (4) raste në vlerë totale prej 76,309€ kishte vonesa në pagesa përtej afatit ligjor prej 30 ditë;
- B4 MKRS në fund të vitit 2023 kishte avance të hapura për udhëtime zyrtare në vlerë 28,330€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë, klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve dhe shpalosja jo e saktë dhe e plotë e shënimeve financiare.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjisllacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus i veçantë duhet të i kushtohet procesit të dhënies dhe menaxhimit të subvencioneve, aplikimin e procedurave të prokurimit, vonesave në mbyllje të avanceve dhe vonesave në pagesën e faturave.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësimit e kontrolleve të brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe katër (4) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja

Neni 13 i Rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu, memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimit e punëve të kryera nga OE projekti do të kalojë në pronësi të komunës. Po ashtu, neni 6.3 potencon "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV), ishte nënvlerësuar për 995,305€ (shkaktuar nga mbivlerësimi për 159,593€ si rezultat i mos-bartjes së pronës së projektit të përfunduar tek komuna përfituese dhe nënvlerësimi për 1,154,898€ si rezultat i mos regjistrimit të pasurive). Po ashtu, vlera e pasurive jo kapitale ishte nënvlerësuar për 41,497€. Çështjet që kishin ndikuar në regjistrin e pasurive janë si në vijim:

- Për projektin "Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Greme" Ferizaj i

cili ishte bashkëfinancim me komunën përfituese, dy (2) transaksione të testuara në vlerë 159,593€ ishin ende të regjistruara si investim në vijim, edhe pse pranimi teknik ishte bërë më 22.06.2023. Regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për të njëjtën shumë pasi nuk ishte bërë bartja e investimit te komuna përfituese;

- “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi Suharekë” në vlerë 1,000,000€, bashkëfinancim me komunën e Suharekës, nuk ishte regjistruar duke e nënvlerësuar regjistrin e pasurive për të njëjtën shumë;
- Lidhur me aktivitetin “Paisje me programin Archicad 26 për MKRS dhe institucionet vartëse për trashëgimi kulturore” pagesa në vlerë 87,278€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë duke e nënvlerësuar atë për të njëjtën shumë;
- Për projektin “Furnizim me paisje për digjitalizimin e Librave, Gazetave dhe Hartave” tre pozicione në vlerë prej 18,000€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive. Shpenzimet ndërlidhen me përgatitjen e pasurisë së blerë për vënie në përdorim. Si rezultat, regjistri i pasurisë ishte nënvlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin “Furnizim me server për nevoja të BKK-së” në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, pagesa në vlerë 19,895€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë duke e nënvlerësuar për të njëjtën shumë;
- Për projektin “Furnizimi dhe montimi dhe konfigurimi i rrjetit LAN” në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (BKK) transaksioni në vlerë prej 29,725€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë duke e nënvlerësuar për të njëjtën shumë;
- Po ashtu, blerjet për BKK “Furnizim me paisje të IT në vlerë 4,730€ dhe “furnizimi dhe montimi i inventarit në hapsirat e këndit Amerikan të BKK-së” në vlerë prej 8,719€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë.

Për më tepër, edhe vlera e pasurive jo kapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 28,048€. Në PFV nuk janë shpalosur pasuritë nga regjistri i Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale (AMMKM) me vlerë 11,481€ dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës (BKK) me vlerë 16,567€.

Mangësitë e identifikuar të cilat kishin ndikuar në nënvlerësimin e regjistrave në SIMFK dhe e-pasuria, kishin ardhur si rezultat i mungesës së përcjelljes së informatave për projektet e përfunduara, si dhe mos komunikimit të duhur për projektet e bashkë financuara me komuna, dhe në mes njësive me rastin e ekzekutimit të pagesave në fund të vitit raportues.

Ndikimi

Mos bartja e pronësisë së pasurive te komunat përfituese, si dhe mos regjistrimi i plotë i pasurive në regjistra ndikon në paraqitjen jo të drejtë dhe të saktë, mbivlerësimin/nënvlerësimin e tyre në PFV. Në anën tjetër, pasuritë e paregjistruara mund t'i ekspozohen rrezikut të humbjes dhe tjetërsimit.

Rekomandimi B1

Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike, përmes procedurave formale, të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë t'i largoj ato nga regjistrat e pasurisë së ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet regjistrimi i pasurive kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që Organizatat Buxhetore (OB) duhet të i aplikojnë.

MKRS gjatë vitit 2023 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 135,322€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Pagesa në vlerë 87,279€ "Pajisje me programin Archicad 26 për MKRS dhe institucionet vartëse" e cila për nga natyra i takon kategorisë investime kapitale ishte ekzekutuar nga kategoria mallra dhe shërbime;
- Pagesa në vlerë 19,895€ "Furnizim me server për nevoja të BKK-së" e cila për nga natyra i takon kategorisë investime kapitale ishte ekzekutuar nga kategoria mallra dhe shërbime; dhe
- Pagesat në vlerë 28,148€, ishin ekzekutuar nga Thesari sipas Vendimeve Gjyqësore nga kategori jo adekuate. Prej tyre, pagesa në vlerë 19,840€ ishte ekzekutuar nga kategoria mallra dhe shërbime, ndërsa i takonte kategorisë investime kapitale, e që kishte të bënte me pagesën e borxhit për kryerjen e punimeve në poligonin sportiv për SHMFU "8 Dëshmorët", dhe vlera 6,691€ i takon kategorisë paga dhe mëditje, për pagesën e pagave të papaguara. Ndërsa, vlera 1,617€ që i takon kategorisë mallra dhe shërbime ishte realizuar nga kategoria paga dhe mëditje, e që kishte të bënte me shpenzimet për shfrytëzimin e automjeteve.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i planifikimit jo të duhur ekonomik. Po ashtu, ishte ndikuar nga ekzekutimi i pagesave përmes Thesarit sipas vendimeve të Gjykatës.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike kanë ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke shkaktuar mbivlerësim të kategorisë mallra dhe shërbime dhe paga dhe mëditje, në anën tjetër nënvlerësim të kategorisë investime kapitale.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos përfshirja e kthimit të donacioneve në PFV

Gjetja Neni 13, pika 1 e Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, parasheh se “Pasqyra e parë financiare përfshin totalin e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme të ndara sipas kategorive”.

Në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme nuk ishte prezantuar kthimi i donacioneve me vlerë 36,167€. Si pasojë pranimet dhe pagesat ishin nënvlerësuar për të njëjtën shumë. Gabimi ishte reflektuar edhe te raporti i ekzekutimit të buxhetit.

Shkaku i mos prezantimit të kthimit të donacioneve, ishte pasojë e neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për prezantimin e tyre në PFV.

Ndikimi Mos prezantimi i kthimit të donacioneve, kishte ndikuar në nënvlerësimin e pasqyrës së pranimet dhe pagesave në PFV.

Rekomandimi C1 Ministri përmes zyrtarëve përkatës duhet të forcojë kontrollet dhe duhet të sigurojë që vlerat financiare të pagesave dhe pranimeve, të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Vonesat në arsyetimin e subvencioneve

Gjetja

Ministria me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanseve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen sipas marrëveshjeve të nënshkruara kryesisht në fund vit, apo bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara në bazë të afateve të parapara me kontrata.

Në 19⁵ raste të testuara në vlerë totale prej 2,585,765€ përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve me kohë, të cilat sipas marrëveshjeve do të duhej të ishin mbyllur. Avancet figurojnë ende të hapura.

Për më tepër, në një rast pagesa për "Federatën e Xhudos" ishte bërë në vlerën e plotë edhe pse me marrëveshje ishte e paraparë që të ekzekutohej në dy pjesë. Pagesa ishte ekzekutuar në vlerë 63,504€ në vend se të ekzekutohej vetëm 31,752€, duke anashkaluar kushtet e përcaktuara me marrëveshje. Rrjedhimisht, është bërë i pazbatueshëm arsyetimi i pjesës së pranuar si parakusht për ekzekutimin e pagesës së mbetur siç parashihet me marrëveshje.

Kjo ishte si pasojë e mos funksionimit të duhur të sistemit të monitorimit të shpenzimeve të federatave nga MKRS, dhe si pasojë e mungesës së mekanizmave adekuat që do t'i kushtëzonte përfituesit që të raportojnë për projektet e subvencionuara.

Ndikimi

Vonesat në arsyetimin e subvencioneve nga federatat dhe numri i lartë i subvencioneve të pa arsyetuara bënë të pamundur konfirmimin nëse objektivat e ministrisë dhe vlera për para është arritur. Mos arsyetimi dhe raportimi për projektet e subvencionuara, mund të dëmtojnë buxhetin e ministrisë dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara arsyetohen në kohën e paraparë dhe të jenë konform kërkesave të memorandumit, mbështetur me dokumente valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Dobësi në aplikimin e procedurave të prokurimit dhe hartimin e dosjeve të tenderit**Gjetja**

Neni 54.15 i Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik, përcakton se kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve " ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavan plus/minus tridhjetë përqind (30%); dhe Neni 27 të Ligjit për prokurimin publik 04/L-042 përcakton "Autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj".

Në testimin e dy (2) procedurave tenderuese kemi hasur në dobësi si në vijim:

- Për procedurën "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentareve për nevojat e MKRS-së dhe institucioneve vartëse" me vlerë të parashikuar 800,000€, ministria ka përdorur kontratën publike kornizë me çmim për njësi dhe përkundër rregullave ka aplikuar pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%). Vlerësimi i tenderit ishte bërë duke u bazuar në peshën e përcaktuar në dosje të tenderit, ndërsa me kontratë është specifikuar se devijimi i lejuar nga vlera e kontratës është +/-30%; dhe
- Dosja e tenderit lidhur me procedurën "Furnizim me materiale të kostumografisë për nevojat e Filharmonisë së Kosovës" e cila kishte rezultuar me kontratë në vlerë 49,699€, nuk përmbante specifikat e tenderit. Ndërsa, tek përshkrimi i çmimeve ishte bërë një specifikim/kriter jo matës duke e theksuar "cilësia e lartë" krahas disa pozicioneve të furnizimit;

Kjo ishte si rezultat i mungesës së kontrolleve lidhur me aplikimin e procedurave të prokurimit.

Ndikimi

Mos-respektimi i dispozitave ligjore lidhur me aplikimin e procedurave jo të duhura të prokurimit mund të ndikoj në mangësi në realizimin e kontratës, tejkalim të shpenzimeve dhe të sjellë vështirësi në realizimin e projekteve tjera të ministrisë.

Rekomandimi A1

Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të siguroj që po zbatohen kontrollet e duhura me rastin e aplikimit të procedurave të prokurimit, respektimin e dispozitave ligjore që garantojnë konkurrencën, dhe po bëhet ekzekutimi i kushteve të pagesës të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit dhe limiteve të lejuara. Po ashtu, planifikimi i prokurimit të bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të prokurimit, departamentin e buxhetit dhe njësisë kërkuese, në mënyrë që të bëhet një planifikim i duhur i procedurave për të siguruar vlerën për para.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Vonesa në nënshkrimin e kontratave mes përfituesve dhe MKRS**Gjetja**

Rregullorja e MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 22, pika 1 përcakton që ofruesi i mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim me përfituesin e mbështetjes financiare brenda 90 ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike, si dhe pika 2.1 përcakton se kontrata me përfituesin përmban detaje lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin/programin e përfituesit.

Në nëntë (9) kontrata në vlerë 326,082€, sipas thirrjeve publike, mes përfituesve dhe MKRS identifikua vonesa dhe dobësi në nënshkrimin e kontratave.

Vonesat/dobësitë ishin si në vijim:

- Për thirrjen "Art dhe Trashëgimi Kulturorë" afati për aplikim ishte deri më 22.03.2023, janë evidentu në pesë (5) raste vonesa në nënshkrimin e kontratave prej 58 deri 73 ditë përtej afatit të lejuar, dhe në tre (3) raste kontratat nuk përmbanin afatet kohore për fillim dhe mbarim të projektit. Po ashtu, kontratat ishin të pa protokoluara; dhe
- "Thirrja publike për Fushën e Rinisë", afati për aplikim ishte deri më 18.04.2023 ishte evidentuar (1) një rast vonesë në nënshkrimin e kontratës me 105 ditë përtej afatit të lejuar.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e vonesave në vlerësimin e projekt propozimeve, si shkak i numrit të madh të kontratave.

Ndikimi

Vonesa në nënshkrimin e kontratave mund të ndikoj që projekt-propozimet të mos arrijnë objektivat e duhura, si dhe të mos realizohen sipas afateve të parapara brenda vitit.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të siguroj se ekzistojnë mekanizma të duhur për të siguruar se për çdo mbështetje financiare lidhet kontrata me përfituesin në përputhje me kërkesat ligjore në mënyrë që të arrihen objektivat e synuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C2 - Vonesat në realizimin e kontratave****Gjetja**

Te dosja e tenderit, pika 5.3 përcakton "Afatet kohore për fillim dhe përfundimin e kontratës; Më tej neni 70.11 i RrUOPP, përcakton se "Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës.

Në tre (3) raste të testuara kemi vërejtur se MKRS nuk kishte respektuar afatet/kushtet e përcaktuara me kontratë:

- Kontrata për "Furnizim, mirëmbajtje, servisim për nevojat e MKRS Lot 1" me vlerë 20,840€, ishte lidhur më 07.12.2022, me afat përfundimi

10 ditë. Furnizimi është pranuar me 10 muaj vonesë. Po ashtu, plani i menaxhimit të kontratës ishte hartuar me vonesë me datë 20.09.2023;

- Kontrata për "Furnizim me veshmbathje" me vlerë 49,699€, e datës 03.03.2023, me afat përfundimi 45 ditë. Pranimi i mallit është bërë në dy pjesë, datë 08.06.2023 dhe 28.07.2023. Po ashtu, plani i menaxhimit të kontratës ishte hartuar më vonesë me datë 01.06.2023;
- Kontrata për "Pajisje me programin Archicad 26 për MKRS dhe institucionet vartëse" në vlerë 92,942€, e datës 11.07.2023, me afat përfundimi 60 ditë. Ministria kishte hartuar planin e menaxhimit të kontratës me vonesë më datë 23.08.2023. Kjo kontratë deri në kohën e përfundimit të auditimit (15.03.2024) nuk kishte përfunduar, me arsyen se nuk ishin shpërndarë të gjithë kompjuterët.

Vonesat në realizimin e kontratave kishin ndodhur në mungesë të vlerësimit jo adekuat të nevojave nga njësia kërkuese dhe planifikimi jo i mirë i menaxhimit të kontratës.

Ndikimi

Mos përmbushja e kontratës me kohë për arsye të brendshme nga ana e Ministrisë rrit rrezikun e humbjes financiare pasi që mund të jetë e detyruar të paguajë kosto shtesë për operatorin ekonomik, përfshirë dëmshpërblim të mundshëm ose kosto tjera për zgjidhje alternative.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës në procese të tenderimit të kërkojë zbatim të plotë të procedurave dhe kërkesave për çdo kontratë publike të nënshkruar bazuar në kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C3 - Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara

Gjetja

Neni 39 i Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim. Po ashtu, neni 6 i Rregullës Financiare nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore, përcakton afatin për dorëzimin e raporteve për obligimet e papaguara prej 15 ditë pas përfundimit të muajit për gjendjen e muajit paraprak.

Lidhur me menaxhimin e obligimeve të papaguara janë identifikuar katër (4)⁷ raste në vlerë totale prej 76,309€ ku faturat ishin paguar me vonesë më tepër se 30 ditë. Vonesat ishin nga 2 muaj deri në 6 muaj. Për më tepër, këto obligime nuk ishin shpalosur në raportet e obligimeve të papaguara në Thesar për muajt përkatës.

Vonesat ishin kryesisht të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikimi jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara. Mos përfshirja e obligimeve në raportet për obligimet e papaguara, ka ndodhur pasi MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të faturave.

Ndikimi

Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbarimore të cilat

njëherit rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi C3 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat të procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit, njëherit edhe raportimi i tyre në Thesar të bëhet i plotë dhe në baza periodike të parapara me rregulla financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare

Gjetja UA nr. 2004/07 për Shpenzimet e Udhëtimeve Zyrtare, si edhe Neni 9, paragrafi 1 i Rregullores (QRK) Nr.06/2023 për Kompenzimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit përcakton "Kërkesa për kompensim dhe shpenzime të vogla së bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet njësisë përkatëse për buxhet dhe financa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar", dhe Neni 10, paragrafi 4 përcakton "Në rast kur zyrtari nuk kthen shumën, ajo do të ndalohet sipas sistemit të pagave".

MKRS, në nenin 20 të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) kishte raportuar avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë prej 28,330€. Nga kjo shumë, vlera prej 8,336€ ishin avance të pambyllura nga vitet paraprake (2010-2022), përderisa avance të pambyllura për vitin 2023 ishin në vlerë prej 19,994€.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve ligjore për kthimin e mjeteve nga menaxhmenti i ministrisë ndaj zyrtarëve.

Ndikimi Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare brenda afatit ligjor dhe mos mbyllja e avanceve, rritë rrezikun që paratë të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo të keqpërdoren.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 22,318,902€, prej tyre ishin shpenzuar 22,037,975€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja B5 - Dobësi në procesin e thirrjeve publike/vlerësimit të subvencioneve

Gjetja

Neni 17 i rregullores MKRS - Nr. 09/2015 për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit, thekson se “Komisioni për vlerësimin e projekteve duhet të kryej punën e vet brenda afatit prej 15 ditë pune, nga data e mbylljes së konkursit”. Po ashtu neni 17 i rregullores 04/2017 pika 1 thekson se brenda pesë (5) ditëve nga data e mbylljes së thirrjes publike, Komisioni Vlerësues bën hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale duke përfshirë kriteret për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas nenit 10 dhe 11 të kësaj Rregulloreje.

Procesi i vlerësimit për tre (3) thirrjet publike ishte përcjellë me vonesa, si në vijim: “Art dhe Trashëgimi Kulturore” 45 ditë “Art dhe Kulturë” 18 ditë dhe “Hulumtim dhe Dokumentim” 10 ditë.

Po ashtu, në tre (3) raste për subvencionet e përfituara, dëshmitë e ofruara nuk ishin sipas kërkesave të thirrjes për OJQ:

- Projekt-propozimi “7 Artet” në vlerë 70,000€, ishte ofruar qarkullimi vjetor për vitin 2020-2021 përderisa kriteri i thirrjes publike ishte qarkullimi vjetor për vitet 2021-2022;
- Projekt-propozimi “Dita e solidaritetit në Kosovë 2023-2024” në vlerë 36,082€, ishte ofruar qarkullimi bankar vetëm për vitin 2022, përderisa kriteri i thirrjes publike ishte qarkullimi vjetor për 2 vitet e fundit. Sipas thirrjes, projekti do të duhej të përfundojë në vitin 2023, ndërsa në projekt propozim parashiheshin aktivitete edhe për vitin 2024; dhe
- Projekt-propozimi “Sportist dhe Çlirimtar” në vlerë 14,780€, ishte ofruar vetëm konfirmimi që është deklarues i rregullt në Administratën Tatimore të Kosovës, përderisa kriteri i thirrjes ishte qarkullimi vjetor/pasqyrat financiare për vitin 2021-2022.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e menaxhimit jo të mirë të procesit të dhënies së subvencioneve, numrit të madh të aplikimeve dhe vështirësitë e krijuara gjatë aplikimit online përmes linkut në webfaqen e ministrisë.

Ndikimi

Vonesat në vlerësim bëjnë të pamundur konfirmimin nëse objektivat e Ministrisë janë arritur dhe rrisin mundësinë e përdorimit të fondeve për qëllime tjera. Po ashtu, mos përfillja e plotë e kërkesave sipas thirrjes publike mund të rezultojë në përzgjedhje jo të drejtë e të bazuar në kërkesa ligjore. Dobësitë e identifikuar kanë ndikim në mos zbatimin e projekteve sipas afateve të parapara brenda vitit.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të siguroj se procesi i vlerësimit të projekteve për subvencionim bëhet në përputhje me afatet kohore të parapara sipas

rregullores për subvencionim, dhe në bazë të kriterëve të parapara në thirrjet publike. Po ashtu, të sigurojë që kriteret e vendosura në thirrje publike aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 24,259,866€, prej tyre ishin shpenzuar 12,999,725€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me renovimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore etj.

Çështja B6 - Vonesat në realizimin e punimeve

Gjetja

Nenet 61.6, 61.19 dhe 61.20 të Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit. Po ashtu, bazuar në dispozitat e marrëveshjeve të bashkëpunimit me komunat përkatëse, përcaktohet që: MKRS në bashkëpunim me komunat përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit.

Në pesë (5) raste në MKRS (prej tyre 2 projekte bashkëfinancim me komunat) dhe dy (2) raste të AMMKM, kemi identifikuar që punimet nuk ishin realizuar sipas kushteve kontraktuale. Rastet e identifikuar si dhe ditët e vonesave janë llogaritur sipas kontratës/projektit deri në dhjetor 2023, apo me rastin e shkëputjeve të kontratave deri në kohën e ekzekutimit të auditimit, datë 15.03.2024, si në vijim:

- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Ferizajit me datë 15.07.2019 për bashkëfinancimin e projektit. Komuna kishte nënshkruar kontratën “Ndërtimi i Qendrës Multifunkcionale në Ferizaj - projekt tre vjeçar” me vlerë 3,299,321€ me datë 13.08.2020. Sipas pikës 10.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK), afati i përfundimit të punëve ishte 12.08.2023. Me datë 07.08.2023 është bërë kërkesë nga Operatori Ekonomik (OE) për ndërprerje të kontratës, përderisa me datë 10.10.2023 ishte bërë pranimi teknik i punëve të përfunduara deri me atë datë sipas të cilit punë të ekzekutuara/realizuara në bazë të pagesave ishin 37% e vlerës së kontratës;
- MKRS kishte nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Komunën e Suharekës me datë 30.07.2020 për bashkëfinancimin e projektit. Komuna kishte nënshkruar kontratën “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi Suharekë” në vlerë 2,712,712€ me datë 15.08.2023. Sipas pikës 17.2 të KVK afati i përfundimit të punëve ishte 13.11.2023 i llogaritur me 75 ditë kalendarike. Vonesat në përfundimin e projektit ishin 2 muaj, megjithëse deri në kohën e përfundimit të auditimit (15.03.2024) ky projekt ende nuk kishte përfunduar. Punë të ekzekutuara/realizuara në bazë të pagesave deri në fund vit ishin 56%. Shkak për vonesat dhe mos përmbylljen e projektit ishte planifikimi jo i duhur i planit dinamik për përfundimin e punimeve;
- MKRS kishte nënshkruar kontratën “Kisha Katolike Ferizaj” në vlerë 473,326€ me datë 23.12.2021. Sipas pikës 9 të KVK-së afati i përfundimit të punëve ishte 23.01.2023. Sipas planit dinamik pas amendamentimit të kontratës, punët do të duhej të përfundonin me 07.12.2023, por projekti nuk ishte përmbyllë ende, përderisa sigurimi

- i ekzekutimit ka skadu me datë 31.12.2023;
- MKRS kishte nënshkruar kontratën për “Intervenime emergjente në Hamamin e Gazi Mehmet Pashës në Prizren, në shtëpinë e familjes Lokvica në Prizren dhe Hamamin e Qytetit në Mitrovicë” në vlerë 342,899€ me datë 15.04.2022. Sipas pikës 9 te KVK, data e përfundimit të punëve ishte 15.10.2022. Në bazë të kërkesë (21.09.2022) me arsyetimin se janë bërë gabime në paramasë është bërë amandamentimi i kontratës me datë 11.01.2023 (pa afat përfundimi). Me datën 04.09.2023 është nxjerrë një vendim për shtyrje të afatit deri me 25.12.2023. Me gjithë zgjatjet e afatit, raporti i pranimit teknik është bërë me datë 04.03.2024. Shkaqet e vonesave për mos realizimin e punimeve në bazë të kontratës bazë dhe nevojës për amandamente të kontratës janë projekti i restaurimit jo i detajuar, kushtet atmosferike, mungesa e stafit profesional të punëkryesit;
 - MKRS kishte nënshkruar kontratën për “Hartimi i projektit per konzervimin dhe restaurimin e monumentit Muzeu Kombëtar i Kosovës” në vlerë 95,000€ datë 10.11.2022. Sipas pikës 4 te KVK, data e përfundimit 08.02.2023. Meqenëse projekti ishte i ndërlikuar, dhe do të duhej të kalojë nëpër shumë komisione për aprovim nga IKMM, menaxherja e kontratës me datë 24.10.2023 ka bërë kërkesë për zgjatje të afatit, dhe me datë 30.10.2023 është marrë vendim për amandamentim për shtyrje të afatit deri me 23.11.2023. Shkaqet e vonesave për mos realizimin e hartimit të projektit në bazë të kontratës bazë dhe nevojës për amandamentim të kontratës janë ndërlikueshmëria e projektit, kalimi nëpër shumë procedura për marrjen e lejes e të cilat nuk ishin parapa fillimisht nga njësia kërkuuese;
 - AMMKM kishte nënshkruar kontratën për “Ndërtimi i varrezave të veteranëve në kompleksin memorial në Kleqkë” vlerë 222,933€, datë 25.08.2023, me afat përfundimi 28.12.2023 (varësisht edhe nga kushtet atmosferike). Projekti nuk ka përfunduar ende dhe punë të ekzekutuara/realizuara për projektin deri në fund të vitit në bazë të pagesave ishin 76%;
 - AMMKM kishte nënshkruar kontratën për “Ndërtimi i Obeliskut të Radio Kosovës së Lirë dhe Bunkerit në kompleksin memorial “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleqkë dhe Divjakë-Malet e Berishës” vlerë 29,951.28€ datë 07.12.2022 me afat përfundimi 07.01.2023 (varësisht edhe nga kushtet atmosferike). Projekti nuk ka përfunduar ende dhe punë të ekzekutuara/realizuara deri në fund të vitit në bazë të pagesave ishin 40%.

Për më tepër, ishin hasur vonesa edhe në 10⁸ projekte të përmbyllura te AMMKM, nga një deri në nëntë muaj.

Sipas arsytimit të dhëna nga menaxherët e kontratave arsyet e vonesave janë kryesisht kushtet atmosferike, zgjatja e procedurave për aprovimin e punëve shtesë, punët e pa planifikuara, inflacioni i çmimeve, situata pandemike e të cilat në disa raste kanë qenë shkak edhe i ndërprerjes së kontratave dhe nevojës për amandamente të kontratave.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore në vitet vijuese, po ashtu ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara të ministrisë.

Rekomandimi B6 Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave/shkëputjeve të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 60,935,830€ pasurive jokapitale 298,368€ si dhe e stoqeve 21,913€.

Çështja B7 - Mangësi në inventarizimin e pasurive dhe caktimin e komisioneve

Gjetja Neni 19 i rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore, përcakton formimin e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive dhe ndër të tjera thekson përgjegjësinë për hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Ministria, dhe njësitë vartëse të saj, kishin themeluar komisionet për inventarizim të pasurive për vitin 2023. Komisionet për ministrinë, BKK dhe ASHAK krahas raporteve individuale të numërimit nuk kishin hartuar një raport përmbledhës të harmonizuar. MKRS nuk kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive me arsyetimin se nuk ka qenë e nevojshme, po ashtu edhe nga komisionet e vlerësimit të themeluara nga njësitë vartëse nuk është ofruar ndonjë raport.

Ministria nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për menaxhimin, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, sipas kërkesave të nenit 4 të rregullores 02/2013. Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të ministrisë sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi Mos aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme kishte ndikim në mos harmonizimin e gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, e cila rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi B7 Ministri duhet të sigurojë se themelohen komisionet përkatëse dhe bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, ZKA duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë për shkak të shtrirjes së gjerë të insitucioneve vartëse në kuadër të MKRS.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C4 - Mangësi në sistemet e menaxhimit të pasurisë

Gjetja Neni 6.3 i rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, potencon "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Ministria nuk kishte zbatuar në tërësi kërkesën për mbajtjen e regjistrit

kontabël në sistemin e-pasuria. Sistemi vazhdon të mos përdoret në njësinë vartëse të ministrisë në ASHAK ku nga viti 2020 nuk kishte zyrtar të pasurisë.

Kjo ishte për shkak të dobësive në funksionim të kontrolleve të brendshme, mungesës së zyrtarit për pasuri te ASHAK.

Ndikimi

Mos funksionimi i sistemit për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon ministria, si dhe mund të rezultojë në humbjen e tyre.

Rekomandimi C4

Ministri duhet të sigurojë se aplikohet sistemi i regjistrimit të pasurive jo-kapitale në sistemin e-pasuria me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV. Po ashtu, njësitë vartëse të plotësojnë pozitat me zyrtarë të pasurisë dhe të njëjtit të trajnohen për përdorimin e sistemit e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Çështja e identifikuar gjatë procesit të auditimit iu komunikua menaxhmentit dhe u zgjidhë në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual.

Çështja 1

Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Neni 9, paragrafi 2 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr.07/2022 Për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik përcakton se: "Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni dhe mos regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë.

Ministria përmes akte mërimeve kishte të angazhuar 20 punonjës sipas Marrëveshjes së Brukselit, bazuar në vendimin e Qeverisë nr.06/39 të datës 22.07.2015, përderisa nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Vlera e pagesave të realizuara për vitin 2023 ishte 90,025€.

Veprimi i kërkuar

Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Rezultati

Ministria me datë 25.10.2023 kishte marr vendim për të pezulluar pagat e këtyre punonjësve deri në gjetjen e një alternative. Pas marrjes së vendimit për pezullim, MKRS nuk kishte paguar mjete për këta punonjës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ^o | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e fondeve | 57,017,861 | 59,524,506 | 46,211,509 | 25,103,236 | 32,632,436 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 56,930,471 | 59,235,757 | 46,078,554 | 24,930,327 | 32,532,239 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 27,085 | 4,828 | 10,456 | 9,148 |
| Të hyrat vetanake | 87,390 | 87,390 | 23,178 | 6,065 | 8,091 |
| Donacionet vendore | 0 | 18,898 | 10,000 | 0 | 0 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 155,376 | 94,949 | 156,388 | 82,958 |

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 2,506,645€. Kjo rritje është si rezultat kryesisht i vendimeve të Qeverisë për mbështetje në kategorinë e subvencioneve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sportit.

Në vitin 2023, MKRS ka shpenzuar 78% të buxhetit final, ose 46,240,339€, me një performancë më të lartë krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 57,017,861 | 59,524,506 | 46,211,509 | 25,103,236 | 32,632,436 |
| Pagat dhe mëditjet | 5,531,454 | 6,256,813 | 6,226,003 | 4,880,533 | 4,968,085 |
| Mallrat dhe shërbimet | 4,811,950 | 6,127,193 | 4,553,493 | 3,152,252 | 2,818,240 |
| Komunalitë | 467,908 | 561,733 | 394,313 | 264,618 | 278,081 |
| Subvencionet dhe transferet | 14,166,550 | 22,318,902 | 22,037,975 | 13,021,111 | 15,439,950 |
| Investimet Kapitale | 32,040,000 | 24,259,866 | 12,999,725 | 3,784,720 | 9,128,081 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 725,359€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë në vlerën prej 661,227€ dhe ndarjes së granteve të donatorëve në vlerë 64,132€. Realizimi për këtë kategori ishte 100% e buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 1,315,243€. Rritja ishte ndikuar nga levizjet buxhetore sipas vendimeve për transfere në mes në kategorive ekonomike në vlerë 353,150€, dhe vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë 840,955€, të hyrat vetanake të bartura në vlerë 27,085€, si dhe ndarjet nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 94,053€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 75%;


- Buxheti final për shpenzimet komunale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 93,825€ e ndikuar nga vendimet e Qeverisë për ndarje buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 70% e buxhetit final;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 8,152,352€. Rritja ishte ndikuar nga levizjet buxhetore sipas vendimeve për transfere në mes në kategorive ekonomike në vlerë 1,849,625€ dhe vendimeve të Qeverisë për mbështetjen në fushën e trashëgimisë kulturore dhe sportit në vlerë 3,791,664€, vendimit të Qeverisë zbatimin e masës 4.3 nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike në vlerë 2,500,000€ dhe ndarjet nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 11,063€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 99%;

- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 7,780,134€ si rezultat i rregullimeve të brendshme në vlerë 2,197,775€ dhe deklarimeve për kursim në vlerë 5,582,359€. Shpenzimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 54%. Ky nivel i ulët i realizimit ishte si rezultat i mos fillimit/zbatimit të procedurave të prokurimit për projekte kapitale, anulimit të procedurave, mos inicimit të kërkesave nga njësia kërkuese. Disa nga projektet që e kanë ndikuar realizimin e ulët të buxhetit ishin: mos realizimi i projektit të paraparë për ndërtimin e objektit të teatrit dhe operës me vlerë 2,5mil €, procedurë e cila ishte anuluar me vendim të organit shqyrtues të prokurimit (OSH), projekti për rekuizita sportive me vlerë 750,000€ i cili ishte në proces vlerësimi, projekti për renovimin e teatrit kombëtar me vlerë 400,000€ i cili për vitin 2023 ishte ende në fazën e projektimit, projekti për ndërtimin e palestrës sportive, Podujevë vlerë 400,000€, nuk kishte kërkesë të iniciuar nga njësia kërkuese;

- Me vendim të Qeverisë, janë ndarë mjete buxhetore në shumën prej 2,500,000€ për zbatimin e masës 4.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për mbështetjen e kulturës dhe sportit. Këto mjete nga kategoria Subvencione dhe Transfere ishin ndarë për mbulesën e shumës së garancisë për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2023 ishin në vlerë 88,847€. Këto të hyra janë realizuar kryesisht nga: taksat administrative, participimet dhe të hyrat nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|---------------|---------------|----------------|---------------|
| Totali i të hyrave | 91,583 | 91,583 | 88,847 | 139,703 | 58,412 |
| Të hyrat jo tatimore | 91,583 | 91,583 | 65,999 | 54,077 | 37,125 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 22,848 | 85,625 | 21,287 |

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka rezultuar me 16 rekomandime. Krahas tyre, në progresin e zbatimit të rekomandimeve është përfshirë edhe një rekomandim për Agjencionin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale si rezultat i raportit të vitit paraprak të këtij agjencioni. Nga viti 2023 sipas Ligjit nr. 08/L-063 kjo agjenci është bartur si agjenci ekzekutive në kuadër të MKRS-së.

Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, katër(4) ishin në proces dhe shtatë (7) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|---------------------|---|--|-------------------------|
| 1. | Baza për opinion | Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste të keqklasifikimit të pagesave të cilat kanë ndikuar në prezantimin e drejtë të shpenzimeve në PFV. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 2. | Baza për opinion | Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe monitorimin e vijueshmërisë së rregulltë në punë të punonjësve siç parashihet me aktet ligjore. | Shih kapitullin 3, për çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit. | I zbatuar |
| 3. | Baza për opinion | Ministri përmes zyrtarëve përkatës duhet të sigurojë komunikim efektiv dhe në kohë me avokaturën shtetërore me qëllim të përditësimit të informatave lidhur me detyrimet kontigjente, si dhe të paraqet vlerën e saktë të detyrimeve të papaguara në mënyrë që këto shpalosje të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV-të e vitit 2023. | Janë evidentuar mangësi të ngjashme në shpalosjen e drejtë dhe të saktë të shënimeve në PFV. | Pjesërisht i zbatuar |
| 4. | Baza për opinion | Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike, përmes procedurave formale, të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë t'i largoj ato nga regjistrat e pasurisë së ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet regjistrimi i pasurive jo-kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF. | Situatë e ngjashme është evidentuar edhe gjatë vitit 2023. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 5. | Baza për konkluzion | Ministri duhet të sigurojë se të gjitha projektet e subvencionuara të organizatave jo qeveritare (OJQ) arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste të ngjashme të vonësive në arsyetimin e subvencioneve. | Nuk ka filluar zbatimin |

| | | | | |
|-----|-----------------------------|---|--|-----------------------|
| 6. | Baza për konkluzion | Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat protokollohen, evidentohen si dhe procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që maksimalisht të zvogëlohet vlera e obligimeve të papaguara në fund të vitit, njëherit edhe raportimi i tyre në Thesar të bëhet i plotë dhe në baza periodike të parapara me rregulla financiare. | Rekomandimi është zbatuar pjesërisht. (Çështja C3) | Pjesërisht i zbatuar |
| 7. | Baza për konkluzion | Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste të ngjashme. | Nuk ka filluar zbatim |
| 8. | Baza për konkluzion | Ministri duhet të sigurojë se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhërblerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa. | Megjithëse janë identifikuar një numër i pagesave të tilla edhe në vitin 2023, kjo çështje konsiderohet e zbatuar për shkak të mungesës së ndikimit. | I zbatuar |
| 9. | Baza për konkluzion | Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme duke siguruar që menaxherët e kontratave mbikqyrin realizimin e tyre në plotëni me rregullat përkatëse. Po ashtu, në rastet kur kemi tejkalim të vlerës së kontratës të bëhet shkëputja e tyre sipas dispozitave ligjore. | Nuk kemi evidentuar raste të ngjashme në vitin 2023. | I zbatuar |
| 10. | Baza për konkluzion | Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që egziston një raport i pranimi të mallit/punëve para ekzekutimit të pagesave në mënyrë që të sigurohet që mallrat/punët e pranuar janë në përputhje me kushtet e kontratës. | Rekomandimi vjen nga raporti i AMMKM. Nuk kemi evidentuar raste të ngjashme në vitin 2023. | I zbatuar |
| 11. | Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë se procesi i vlerësimit të projekteve për subvencionim bëhet në përputhje/brenda afateve kohore të parapara sipas rregullores për subvencionim, dhe në bazë të kriterëve të parapara në thirrjet publike me qëllim të zbatimit të projekteve brenda vitit. Po ashtu, të sigurojë që kriteret e vendosura në thirrje publike aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste të ngjashme. | Nuk ka filluar zbatim |

| | | | | |
|-----|----------------------|---|---|-------------------------|
| 12. | Investimet kapitale | Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës në procese të tenderimit të kërkojë zbatim të plotë të procedurave dhe kërkesave për çdo kontratë publike të nënshkruar bazuar në kërkesat ligjore. | Për vitin 2023 janë evidentuar kryesisht vonesa në realizimin e kontratave për shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet dhe ndërlidhen kryesisht me menaxhimin e kontratave. | Pjesërisht i zbatuar |
| 13. | Investimet kapitale | Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës që para përfundimit të kontratës të aplikohet zbritja proporcionale e pagesës së avancit për investime. | Nuk kemi evidentuar raste të ngjashme në vitin 2023. | I zbatuar |
| 14. | Investimet kapitale | Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre. | Edhe në vitin 2023 janë identifikuar raste raste të vonesave në realizimin e punimeve. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 15. | Pasuritë | Ministri duhet të sigurojë se themelohen komisionet përkatëse dhe bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, ZKA duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë për shkak të numrit të lartë të insitucioneve vartëse në kuadër të MKRS. | Edhe këtë vit janë evidentuar mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 16. | Pasuritë | Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, që njësitë vartëse të kompletojnë pozitat me zyrtarë të pasurisë dhe të njëjtit të trajnohen për përdorimin e sistemit e-pasuria. Po ashtu, në bashkëpunim me komunitat duhet ndërmarrë veprime për të siguruar informatat e plota mbi pranimet teknike me qëllim që të azhurnohen regjistrat e SIMFK, përderisa pasuritë e shitura të MKRS në bashkëpunim me MFPT të largohen nga regjistrat. | Janë evidentuar raste të ngjashme për mos përdorimin e e-pasurisë te ASHAK, përderisa BKK kishte bërë progres në regjistrimin e pasurisë. Po ashtu, kishte progres edhe në bartjen e pronësisë së pasurive tek komunitat. | Pjesërisht i zbatuar |
| 17. | Auditimi i Brendshëm | Ministri duhet të sigurojë që NJAB plotësohet me staf të mjaftueshëm, në mënyrë që në plan të auditimit të përfshihen një numër më i madhë i auditimit të njëjësive vartëse të ministrisë si dhe të aktiviteteve të ministrisë. | Ministria gjatë vitit 2023 kishte plotësuar NJAB edhe me një auditor. | I zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ajtene Llapashtica, Udhëheqëse e ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Arnisa Aliu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

| Çështja | Komenti i OB-së | Pikëpamja e ZKA-së |
|---|--|--|
| Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive | <p>Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore</p> <p>Kërkojmë që kjo çështje të zhvendoset të e gjetura C1 dhe mos të merret si bazë për kualifikim të raportit pasi që rekomandimi tani veç është i zbatuar plotësisht, ashtu siç është paraqit në tabelën e komenteve.</p> <p>Pasuritë e paregjistruara nuk mund t'i ekspozohen rrezikut të humbjes dhe tjetërsimit, për shkak se në këto raste s'ka pasur asnjë rrezik të asaj natyre, pasi që pasuritë e lartë cekura kanë qenë në proces të regjistrimit dhe i tërë dokumentacioni është ruajtur dhe përdorur sipas procedurave ligjore.</p> | <p>Gjatë vitit 2024 ministria kishte ndërmarrë veprime për regjistrimin e këtyre pasurive, por nuk kanë ndikim në gjendjen e pasurive të prezantuar në PFV për vitin 2023.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p> |
| Mos përfshirja e kthimit të donacioneve në PFV | <p>MKRS nuk pajtohet me Çështja C1 - Mos përfshirja e kthimit të donacioneve</p> <p>Koment: Kërkojmë të hiqet kjo e gjetur, pasi që veprimet tona janë zhvilluar në përputhje me infrastrukturën ligjin dhe rregulla e cituara.</p> <p>Referenca: Marrëveshjen në mes MKRS dhe European Commission</p> <p>Referenca: Rregulloren MF - Nr. 01/2017, neni 24</p> <p>Reference: Pasqyrat financiare vjetore 2023, citohet Kthim i donacionit</p> <p>Referenca: regjistrimi në SIMFK, regjistruar Kthim i donacionit</p> | <p>Çështja ndërlidhet me prezantimin e kthimit të donacioneve në PFV, dhe nuk konteston aspektet tjera ndërlidhur me këto transaksione.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>Dobësi në aplikimin e procedurave të prokurimit dhe hartimin e dosjeve të tenderit</p> | <p>MKRS nuk pajtohem: Çështja A1 - Dobësi në aplikimin e procedurave të prokurimit dhe hartimin e dosjeve të tenderit</p> <p>Komenti: Kjo gjene zbatim në nenin 54.11 Mospërputhja e lejuar konsiston në plus/minus tridhjetë përqind (30%) të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës, mirëpo, kjo nuk do të thotë që Operatori Ekonomik duhet të paguhet për punët, shërbimet apo furnizimet e pa porositura nga Autoriteti Kontraktues. Sipas këtij kufizimi (+/-30%),</p> | <p>Ministria ka aplikuar kontratën kornizë me çmime për njësi (jo sipas sasive indikative), prandaj në këtë rast nuk vlen pragu +/- 30%. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p> |
|---|---|---|

| | | | |
|---|---------------------------|------------------------|----------------------------|
| REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| DATA PRANIMIT: 21-06-2024 | | | |
| NUMRI I DOKUMENTIT: 03 47 909 2 | | | |
| NUMRI I ORG. Org. No. | SHIFRI I DOK. Doc. No. | NR. PROT. Prot. No. | NR. DOKUMENTIT Doc. No. |
| 03 | 47 | 909 | 2 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry of Culture, Youth and Sport

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Tema: Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe zbatimin e rekomandimeve

20 qershor 2024

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2023;
- pajlohem pjesërisht me gjetjet, rekomandimet dhe komentet për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Hajrulla Çeka, Ministër

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1.Memorandum bashkëpunimi -Kosova Shtet i XHudos në vlerë 433,000€; 2. Memorandum bashkëpunimi, Drejt Malit,Skijim dhe Hiking në vlerë 419,585€; 3. Memorandum bashkëpunimi - Kampionati Evropian i hapur 2023 në vlerë 400,000€; 4. Memorandum bashkëpunimi - Organizimi i Garave Shkollore në vlerë 377,350€; 5. Memorandum bashkëpunimi - Komiteti Olimpik TM4/23 në vlerë 200,000€; 6. Memorandum Bashkëpunimi - Kampionati Evropian FIBA U16 në vlerë 138,020€; 7. Aneks Memorandum - Organizimi I EHF Championship në konkurrencën e femrave 2023 në vlerë 120,000€; 8. Memorandum bashkëpunimi - Kosova Shtet i Xhudos në vlerë 63,504€; 9. Memorandum bashkëpunimi Tour of Kosova në vlerë 60,000€; 10. Memorandum bashkëpunimi - Ngritja e kapaciteteve te organizatave sportive në vlerë 50,000€; 11. Memorandum bashkëpunimi TM3/23 - Federata e Boksit në vlerë 46,338€; 12.Aneks Moramndum - Lojrat Mesdhetare PRISHTINA 2030 në vlerë 41,545€; 13. Memorandum bashkëpunimi - Federata e Volejbollit në vlerë 40,500€; 14. Memorandum bashkëpunimi - Për mbështetje të organizatave sportive në vlerë 38,658€; 15. Memorandum bashkëpunim TM2/23 - Federatës së bjeshkatarisë dhe ngritjes sportive të Kosovësi në vlerë 23,674€; 16. Memorandum bashkëpunimi Kampionati mbarëkombëtar dhe turneo nderkombtar të Shahut në vlerë 22,300€; 17. OJQ “Qendra kosovare për muzikën e re” - Edicioni i XXII i festivalit në vlerë 31,290€; 18.Fondacioni 17 - Programi vjetor I artit dhe edukimit në vlerë 50,000€ 19.Shoqata etnografike trashigimi e gjelbert - Ulpiana Fest 30,000€.
- ⁶ 1. Shoqata etnografike trashigimi e gjelbert - Ulpiana Fest 30,000€. (data e kontratës 13.09.23); 2. OJQ 7 ARTET - Programi vjetor 7 Artet në vlerë 70,000€ (data e kontratës 06.09.23); 3.OJQ Prizren Fest - Festivali ndërkombëtar i teatrit në vlerë 30,000€(data e kontratës 05.09.23); 4. OJQ Hardh Fest - Promovimi i vlerave të trashigimisë kulturore në vlerë 50,000€ data e kontratës 04.09.23); 5. OJQ Art Polis - Katalis kulturor, fuqizimi i skenës së pavarur kulturor në vlerë 80,000€ data e kontratës 28.08.23); Tre kontratat pa detaje të mjaftushme (1.Fat Limani - Pinkmetal beton në vlerë 10,000€; 2.Besmir Olluri - Promovimi online i kulturës dhe trashigimisë kulturore në rajonin e Prizrenit në vlerë 10,000€; 3.Agon Bekteshi - Programi problemet dhe prespektivat kryesore per zhvillimin e turizmit kulturor në vlerë 10,000€) 1. OJQ Toka - Dita e solidaritetit në Kosovë në vlerë 36,082€ data e kontratës 16.11.23;
- ⁷ 1.Renovimi i pallatit të rinisë në vlerë 12,121€ 2.Shkolla Jeronim De Rada Ferizaj në vlerë 2,313.85€ 3.Pajisje tjera <1000 në vlerë 12,710€ 4.Qiraja për ndërtesa në vlerë 49,164.70€
- ⁸ 1.“Intervenimet Emergjente - Renovimi i Memorialëve dhe Lapidarëve në disa Komuna të Kosovës”, vonesa 2 muaj; 2) “Ndërtimi i Kazermës së UÇK-së” Prelofc Skënderaj”, vonesa 2 muaj; 3)“Ndërtimi i memorialit të dëshmorëve të UÇK-së në Tërstenik Drenas, faza II”, vonesa 2 muaj;4) “Ekzekutimi i punimeve faza e VKompleksi Memorial 27 prilli Meje - Gjakovë,” vonesa 1 muaj; 5) “Ndërtimi i shtabit dhe varrezat e dëshmorëve të UÇK-së në Shqiponjë” vonesa 1 muaj; 6) “Ekzekutimi i punimeve në kompleksin memorial të UÇK-së në Marinë, Skënderaj-faza në vazhdim” vonesa 2 muaj;7) “Ndërtimi i lapidarit të dëshmorëve të UÇK-së në Mitrovicë”, vonesa 5 muaj,(projekti pa perfundu der ne Kohen sa ishim ne auditim);8) “Ndërtimi i memorialit Dëshmorët e Hasit, Prizren; vonesa 9 muaj; 9) “Ndërtimi i memorialit Shtëpia-Shtabi i UÇK-së Zhegoc, Gjilan faza e I-rë” vonesa 1 muaj;10) “Ndërtimi i monumentit të zonës operative të Nerodimes - Mollopolc, Shtime”, vonesa 6 muaj.
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.